



BASHKIA PUKË

PLANI I INTEGRITETIT

2022 -2025

Miraturar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr..... Datë2022

Grupi i Punës për Hartimin e Planit të Integritetit në Bashkinë e Pukës

Ershela Gjoni, Nënkryetare e Bashkisë Pukë, Koordinatorë e Grupit të Punës
Flora Palushi, Drejtore e Administrimit të Përgjithshëm
Armir Mehaj, Drejtor i Shërbimeve Komunitare, Utilitare dhe Administrative
Alda Mema, Drejtore e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Territorit
Alda Gjoka, Specialiste e Burimeve Njerëzore dhe Koordinatorë për Informimin
Behar Ademi, Përgjegjës i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave Civile
Endrit Kraja, Përgjegjës i Sektorit Juridik, të Prokurimeve Publike dhe të Arkivit
Nail Aliaj, Përgjegjës për Zyrën e Tatim-Taksave
Edmond Prendi, Përgjegjës për Sektorin e Zhvillimit Rural dhe Bujqësinë

Grupi i Punës, IDM:

Lorena Totoni, Eksperte për Etikën dhe Integritetin
Ledia Canga, Eksperte e Menaxhimit të Riskut

Ky Plan Integriteti është hartuar në kuadër të projektit “Zgjerimi i praktikës standarde të planifikimit të integritetit në nivel vendor”, i financuar nga Projekti STAR 3. Projekti STAR 3 zbatohet nga UNDP në Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe Pushtetin Vendor, dhe financohet nga Bashkimi Evropian dhe qeveritë e Suedisë dhe Zvicrës, UNDP në Shqipëri dhe Qeveria Shqiptare. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë dokument nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe mendimet e UNDP-së në Shqipëri apo të partnerëve të saj zbatues dhe financues.

Deklarata e Integritetit Institucional

Ne, drejtuesit dhe punonjësit e Bashkisë Pukë, e konsiderojmë mbrojtjen dhe përmirësimin e integritetit institucional, si një instrument kryesor për të luftuar shfaqjet e korrupsionit dhe abuzivizmit në nivelin e qeverisjes vendore. Ndërsa punojmë me përkushtim maksimal për sigurimin e shërbimeve cilësore për komunitetin, përiqemi në të njëjtën kohë për të garantuar një nivel sa më optimal të transparencës, llogaridhënies, si dhe përfshirjes e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen e bashkisë.

Ndërkaq, jemi të ndërgjegjshëm që korrupsioni si tendencë për krijimin e privilegjeve dhe përfitimeve personale nga shfrytëzimi i pozicioneve dhe detyrave publike, është një dukuri shumëdimensionale e cila e ka shoqëruar shoqërinë njerëzore gjatë gjithë ekzistencës së vet, prandaj qartazi identifikojmë nevojën për ta parandaluar, kontrolluar dhe menaxhuar proaktivisht atë edhe përgjatë punës dhe veprimtarisë funksionale të bashkisë sonë.

Në këtë kontekst prezantojmë Planin e Integritetit të Bashkisë Pukë. Ky Plan është një dokument i realizuar nëpërmjet një procesi me pjesëmarrje, ku janë përfshirë potencialet dhe burimet njerëzore më të mira të bashkisë, dhe ofron një qasje që mbështet rrënjosjen e kulturës së vlerësimit të vazhdueshëm të integritetit në nivel të qeverisjes vendore, duke forcuar e përmirësuar qeverisjen dhe vlerat e saj nëpërmjet rritjes së rezistencës ndaj korrupsionit.

Ky plan do të sigurojë funksionimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të integritetit në nivel bashkie si dhe do të ndihmojë administratën vendore në përpjekjet e saj për forcimin e etikës dhe integritetit. Ai do t'i japë procesit të vlerësimit të integritetit një dimension të qëndrueshëm institucional, duke lehtësuar zbatimin e politikave parandaluese të përgjegjshme, proaktive dhe të mbështetura mbi vlerësimin e riskut.

Ne, e konsiderojmë këtë Plan një dokument të rëndësishëm dhe relevant që pasuron kuadrin strategjik të institucionit të Bashkisë. Jemi të sigurtë që zbatimi i tij do të kontribuojë në mënyrë pozitive në realizimin e objektivave të programit tonë qeverisës duke na afruar më shumë me synimet në nivel kombëtar për një integrim të plotë e të suksesshëm në Bashkimin Evropian.

Për sa më sipër, angazhohemi institucionalisht për zbatimin rigoroz dhe përditësimin e mëtejshëm të këtij plani në përputhje me sfidat reale për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm në territorin dhe komunitetin që përfaqësojmë. Gjithashtu jemi besimplotë që garantimi i një niveli të lartë të integritetit institucional dhe promovimi i vlerave të mirëqeverisjes do të japë impakt të qëndrueshëm në rritjen e besimit të qytetarëve tek institucioni, duke lehtësuar bashkëpunimin e ndërsjellë për një qeverisje të mirë dhe sigurimin e mirëqenies për qytetarët.

Gjon GJONAJ

Kryetari i Bashkisë Pukë

SHKURTESA DHE AKRONIME

GPI	Grupi i Punës për Integritetin
PI	Plani i Integritetit
ILDKPKI Interesit	Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
AB	Auditi i Brendshëm
BNJ	Burime Njerëzore
PSV	Procedura Standarde Veprimi

Tabela e përmbajtjes

1. Rëndësia e Planit të Integritetit	6
1.1 Procesi i Hartimit të Planit të Integritetit.....	7
1.2 Qasja metodologjike	8
2. Objektivat e Planit të Integritetit	9
3. Plani i veprimit.....	11

1. Rëndësia e Planit të Integritetit

Integriteti institucional përbën një parakusht thelbësor për një qeverisje të mirë. Ai është i lidhur ngushtë me besimin e publikut te qeverisja duke garantuar transparencë, komunikim të hapur, llogaridhënie dhe legjitimitet.

Shkelja e integritetit institucional mund të ketë pasoja që lidhen me cenimin e interesit publik, dëmtimin e besimit të qytetarëve tek administrata publike, si edhe cenimin e imazhit të saj. Prandaj, forcimi i integritetit institucional është një synim i rëndësishëm për qeverisjen vendore, veprimtaria e së cilës ka impakt të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve dhe komuniteteve.

Një institucion me integritet të lartë merr vendime dhe vepron sipas parimeve dhe standardeve etike dhe nuk pranon asnjë tolerancë ndaj qëndrimeve, veprimeve dhe aktiviteteve të punonjësve apo partnerëve të tij që devijojnë prej këtyre parimeve. Si i tillë integriteti nuk mund të ketë vlerë vetëm për nivelet më të larta të qeverisjes dhe administratës, por duhet të përshkojë rrjedhën e aktivitetit të çdo strukture, sektori dhe të gjithë punonjësve që ofrojnë shërbime për publikun e gjerë.

Orientimi i kulturës institucionale drejt të punuarit me integritet nënkupton që ushtrimi i pushtetit, kompetencat, asetet, burimet dhe fondet në dispozicion të bashkisë të përdoren në mënyrën e duhur. Politikat, procedurat dhe rregullat e miratuara për këtë qëllim, parandalojnë dhe reagojnë ndaj korrupsionit, keqpërdorimit të pushtetit ose tejkalimit të kompetencave, si dhe ndaj sjelljeve joetike.

Në këtë kuadër, menaxhimi i integritetit institucional ka për qëllim jo vetëm garantimin e zbatimit me korrektesë të kuadrit ligjor dhe të rregullave në fuqi, por edhe planifikimin e masave që përmirësojnë kapacitetet teknike të punonjësve të administratës vendore për zbatimin e tyre. Përgjegjësitë kryesore për administrimin e këtij procesi u takojnë organeve ekzekutive në bashki, si edhe strukturave përbërëse të saj.

Plani i Integritetit i Bashkisë Pukë paraqitet si një instrument i rëndësishëm për forcimin e integritetit institucional. Ai është një dokument strategjik dhe operacional që rezulton nga procesi i vlerësimit të riskut të integritetit në bashki dhe përfaqëson një kuadër të unifikuar për menaxhimin e integritetit në nivel bashkie.

Plani evidenton sfidat reale me të cilat bashkia ndeshet në aspekte të veçanta të integritetit dhe siguron angazhim të vazhdueshëm të bashkisë për përballimin e tyre me qëllim final rritjen e besimit të publikut, garantimin e një qeverisjeje të mirë dhe një zhvillimi të qëndrueshëm territorial.

Plani i Integritetit synon arritjen e këtyre objektivave:

- Përmirësimi i kuadrit rregullator të bashkisë mbi aspekte të etikës dhe integritetit sipas fushave të përgjegjësisë të bashkisë.
- Menaxhimi efektiv i riskut të integritetit me fokus në fushat e përgjegjësisë së bashkisë.
- Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në gjitha nivelet dhe funksionet në bashki.

Plani i integritetit është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës të planifikimit të integritetit dhe të vlerësimit të riskut të integritetit, gjatë periudhës shkurt - prill 2022. Ky Plan Integriteti është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak Pukë.

1.1 Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit në Bashki

Muaji shkurt i vitit 2022 shënoi nisjen e procesit të hartimit të Planit të Integritetit në Bashkinë Pukë, i cili përfundoi me miratimin e këtij plani nga Këshilli Bashkiak. Administrata e bashkisë duke përfshirë edhe menaxhimin e lartë, kontribuoi aktivisht në procesin e identifikimit, vlerësimit të riskut të integritetit dhe propozimit të masave për adresimin e risqeve dhe faktorëve të tyre. Procesi përfshiu analizën e risqeve të integritetit për proceset e punës në fushat e përgjegjësisë së bashkisë, duke u bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe legjislacionin e zbatueshëm nga bashkia. Fushat e vlerësuara janë si më poshtë: i) Fusha e menaxhimit financiar; ii) Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore; iii) Fusha e kontrollit, auditimit dhe të mekanizmave kundër korrupsionit; iv) Fusha e shërbimeve publike; v) Fusha e administrimit dhe menaxhimit të pronave; vi) Fusha e planifikimit, administrimit dhe zhvillimit të territorit; dhe vii) Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve dhe informacionit, si dhe të dokumenteve elektronike.

Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit për Bashkinë Pukë, janë si më poshtë:

Faza 1: Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerëzore

Më qëllim zhvillimin e një plani integriteti është miratuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Nr. 254 datë 20/9/2021 ngritja e grupit të punës për zhvillimin e Planit të Integritetit në Bashki, i përbërë nga 8 anëtarë dhe 1 koordinator i grupit të punës. Në vijim, grupi i punës komunikoi qëllimin dhe objektivat e Planit të Integritetit me administratën e bashkisë.

Faza 2: Identifikimi dhe analizimi risqeve të integritetit

Nga ana e grupit të punës u analizuan korniza rregullatore, strategjike, si dhe dokumentet e punës së bashkisë. Pjesë e analizës ishin edhe aspektet që japin informacion mbi efektivitetin e funksionimit të sistemit të integritetit në institucion. Më pas u vijua me identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, për proceset e punës sipas fushave funksionale të bashkisë. Për këtë qëllim shërbyen edhe të dhënat cilësore të grumbulluara nga 7 grupet e fokusuara me punonjësit sipas fushave të veprimtarisë së bashkisë.

Më pas grupi i punës analizoi të dhënat nga pyetësi për aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit në bashki. Plotësimi i pyetësorit u realizua elektronikisht dhe në mënyrë anonime nga 45 punonjës të administratës. Ai shërbeu për të mbledhur të dhëna, informacione dhe për të vlerësuar sistemin e menaxhimit të integritetit institucional në bashki.

Faza 3: Plani i masave për menaxhimin e integritetit dhe miratimi

Në vijim të vlerësimit të situatës së menaxhimit të integritetit në nivel bashkie, grupi i punës hartoi planin e veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit në institucion, i cili prezanton një sërë masash të reja si dhe përmirësoi masat ekzistuese të kontrollit në bashki. Masat përshkruajnë aktivitetet që duhet të zbatohen për parandalimin, zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e tyre në nivel organizativ.

1.2 Metodologjia

Për të analizuar dhe vlerësuar cenueshmërinë e integritetit, grupi i punës ka zbatuar dy metoda gjatë procesit të hartimit të planit: metodën cilësore dhe atë sasiore. Metoda e parë përfshiu zhvillimin e një sesioni trajnues me grupin e punës dhe punonjësit e bashkisë mbi metodologjinë e vlerësimit të integritetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe legjislacionin përkatës. Më tej, u krye analiza e kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik të bashkisë (shqyrtim literature), e cila përfshin: urdhra, manuale, strategji apo dokument politikash, rregullore dhe akte të brendshme. Po kështu u bënë kërkime dhe u shqyrtuan faqja e internetit, programi i transparencës së bashkisë, si dhe informacione dhe raporte të tjera mbi veprimtarinë e bashkisë. Më pas u bë analizimi i të dhënave të mbledhura nga grupet e fokusuara me stafin e bashkisë, ku u identifikuan ngjarje negative në realizimin e proceseve të punës, praktika pune dhe funksione të cilat janë të ekspozuara ndaj shkeljeve të integritetit, sjellje joetike e joprofesionale dhe parregullsi të tjera.

Metoda tjetër e përdorur ishte ajo sasiore, përmes vlerësimit me anë të një pyetësori të strukturuar që përfshinte pyetje mbi çështje të veçanta të integritetit dhe etikës në institucion. Pyetësori është një mjet shumë i rëndësishëm për mbledhjen e të dhënave të sakta dhe të kuantifikuara të risqeve të integritetit për aspekte të veçanta të integritetit në bashki. Këtij pyetësori punonjësit e bashkisë iu përgjigjën në mënyrë anonime. Anketimi përfshiu një kampion me 45 punonjës të institucionit me një nivel besueshmërie statistikor 95%. Shkalla e vlerësuar e gabimit është +/- 6 %. Kampioni përfshiu një shpërndarje të gjerë në lidhje me gjininë, moshën dhe vjetërsinë në punë. Të anketuarat femra përbëjnë 59.1% të kampionit krahasuar me punonjësit meshkuj që janë 40.9%.

Punonjësit e moshës 26-35 vjeç kanë përqindjen më të madhe në kampion me 43.2%. Edhe të intervistuarit në moshë 36-45 vjeç kanë përfaqësim të mirë duke përbërë 25% të kampionit. Kategoria e grup-moshës deri në 46-55 vjeç, renditet e treta me 18% të kampionit. Kategoria deri në 25 vjeç përfaqësohet me 11.4 % të kampionit dhe kategoria mbi 56 vjeç përfaqësohet përkatësisht me 2.2 % të kampionit. Vihet re se të anketuarit me më pak përvojë pune, kategoria më pak se 5 vite punë, përbëjnë 40.9 % të kampionit, kategoria me vjetërsi 5-10 vite punë përbën 25% të të anketuarve në bashki, ndërsa ata me 11-20 vite punë përbëjnë 20.5%. Kategoria e punonjësve me përvojë, mbi 21-30 vite punë përbën 9.1% të kampionit dhe ata mbi 30 vite punë përbëjnë 4.5% të kampionit.

2. Objektivat e Planit të Integritetit

2.1 Përmirësimi i kuadrit rregullator të bashkisë mbi aspekte të etikës dhe integritetit sipas fushave funksionale të bashkisë.

Përmirësimi i kuadrit rregullator të bashkisë në lidhje me aspektet e etikës dhe integritetit ka rëndësi të veçantë për të menaxhuar efektivisht integritetin në nivel institucional. Ky objektivi adreson nevojën për rishikim të kuadrit rregullator të integritetit duke e përditësuar me parashikimet ligjore në fuqi për aspekte të integritetit si p.sh konflikti i interesit, sinjalizimi, e drejta për informim etj. Më tej, nëpërmjet përmirësimit të kuadrit rregullator synohet qartësimi i funksioneve e detyrave të njërive në bashki dhe pasqyrimi i ndryshimeve që ka pësuar struktura institucionale. Pavarësisht se bashkia ka hartuar dhe miratuar disa akte të brendshme rregullatore për çështje të ndryshme të integritetit, përmirësimi i mëtejshëm i tyre dhe informimi i stafit të bashkisë mbi to është më rëndësi për zhvillimin e një administrate të aftë dhe profesionale për të menaxhuar shkeljet e integritetit dhe dilemat etike në bashki.

2.2 Menaxhim efektiv i riskut të integritetit me fokus fushat e përgjegjësisë së bashkisë.

Menaxhimi i integritetit të Bashkisë Pukë, në tërësinë e tij paraqet sfida të cilat hasen më së shumti në fusha të veçanta të përgjegjësisë, të tilla si: menaxhimi i burimeve njerëzore, menaxhimi i shërbimeve publike, menaxhimi i pronave të bashkisë, fusha e menaxhimit financiar, si edhe planifikimi i territorit. Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve të integritetit në Bashkinë Pukë, është bërë sipas fushave të veprimtarisë së bashkisë, duke pasur në konsideratë proceset dhe nënproceset kryesore të punës. Disa prej këtyre risqeve lidhen me çështje si: paqartësi rreth proceseve e procedurave të punës, linjave të hierarkisë dhe raportimit, rregullimi i ulët normativ i proceseve, kapacitetet njerëzore të pamjaftueshme dhe të kufizuara teknike, mbingarkesa në punë, bashkëpunim i ulët ndërmjet drejtorive të bashkisë, infrastruktura e kufizuar fizike, pajisjet e pamjaftueshme në bashki etj. Ky objektivi synon menaxhimin e risqeve të identifikuar në kuadër të fushave të përgjegjësisë së bashkisë.

2.3 Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në gjitha nivelet dhe funksionet në bashki.

Përmirësimi i proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në bashki do të sigurojë kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme për të aktivizuar dhe konsoliduar mekanizmat që garantojnë dhe mbrojnë integritetin në institucion. Ruajtja e një niveli të lartë integriteti në proceset e menaxhimit të burimeve njerëzore garanton në vijimësi standarde sjelljeje dhe performancë të dëshirueshme nga stafi dhe drejtuesit e të gjitha niveleve në bashki. Më tej, zbatimi i këtyre standardeve do të kontribuojë cilësisht në rritjen e besimit dhe përmirësimin e imazhit të bashkisë në publikun e gjerë si dhe ofrimin e shërbimeve publike cilësore në nivel vendor.

3. Plani i Veprimit

Plani i Veprimit është një mjet plotësues i politikave dhe kornizës rregullatore për përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional. Ai përmbledh tërësinë e masave të kontrollit që adresojnë risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit të vlerësuara për çdo fushë të përgjegjësisë së Bashkisë Pukë.

Në krye të çdo viti realizohet procesi i monitorimit të këtij Plani dhe ky proces pasqyron kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve, përgjegjës për zbatimin e masave të miratuara në të. Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qenë efektive, nëse kanë nxjerrë në pah ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioritetëve të risqeve (planit të veprimit), si dhe nxjerrjen e mësimëve për planifikim më të mirë në të ardhmen.

Raportimi është një procedurë e rregullt që siguron zbatimin e planit të integritetit për risqet e integritetit sipas afateve kohore të parashikuara. Ky proces ndiqet nga personi përgjegjës, i caktuar nga titullari i institucionit, i cili është përgjegjës për të ndjekur progresin e zbatimit. Frekuenca minimale e raportimit është brenda një periudhe gjashtëmujore. Raportimi i lejon titullarit të ndërmarrë me kohë masa përmirësuese, në rast se zbatimi i ndonjë mase të caktuar ka sjellë vështirësi apo vonesa.

Objektivi 1: Përmirësimi i kuadrit rregullator të bashkisë mbi aspekte të etikës dhe integritetit sipas fushave funksionale të bashkisë.

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Masat prioritare Prioritet i lartë; Prioritet mesatar; Prioritet i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve
1	Mungesë e Kodit të Sjelljes në Bashki.	Operacionet/Reputacional dhe Imazhi	I lartë	<p>1. Hartimi dhe miratimi i Kodit të Sjelljes për institucionin, ku të përfshihen parimet e përgjithshme etike, standardet e sjelljes para, gjatë dhe pas ushtrimit të detyrës, marrëdhënia me publikun, monitorimi dhe sanksionet për shkeljen e normave etike etj.</p> <p>2. Informimi dhe shpërndarja e Kodit tek punonjësit. Publikimi i Kodit në Programin e Transparencës.</p> <p>3. Aplikimi i detyrimit të nënshkrimit të Kodit të Sjelljes çdo vit dhe depozitimi i këtij nënshkrimi pranë Burimeve Njerëzore.</p> <p>4. Trajnime të brendshme në lidhje me rritjen e njohurive të punonjësve rreth Kodit të Sjelljes së Bashkisë.</p>	<p>Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori Juridik, i Prokurimeve Publike dhe Arkivit</p> <p>Gjashtëmuji i dytë i vitit 2022</p>
2	Mungesë e rregullave për parandalimin e konfliktit të interesit në Rregulloren e Këshillit Bashkiak Pukë .	Operacionet/Indicie korrupsioni	I lartë	Hartimi dhe miratimi i dispozitave të plota rregullatore për parandalimin e konfliktit të interesit për anëtarët Këshillit Bashkiak.	Sektori Juridik, i Prokurimeve Publike dhe Arkivit në bashkëpunim me Sekretarin e Këshillit Bashkiak (KB) në vëmendjen e Kryetarit të KB.

					Gjashtëmujori i dytë i vitit 2022
3	Mungesë e rregullave të brendshme për përgatitjen e paketës fiskale.	Operacionet/Ligjor dhe kontraktual	Mesatar	<ol style="list-style-type: none"> Hartimi i rregullave të brendshme për përgatitjen e Paketës së Taksave dhe Tarifave Vendore në bashki, duke përcaktuar rolin dhe detyrat e secilës drejtori të përfshirë. Informimi i personelit të të gjithë drejtorive mbi këto rregulla. Publikimi i tyre në Programin e Transparencës. 	<p>Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Ndhmës Ekonomike në bashkëpunim me Zyrën e Tatim Taksave, Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Sektorin Juridik, të Prokurimeve Publike dhe Arkivit</p> <p>Koordinatori për të Drejtën e Informimit</p> <p>Gjashtëmujori i parë i vitit 2023</p>
4	Mungesa e Procedurës Standarde të Veprimit (PSV) për hartimin e Termave të Referencës për prokurimet publike.	Operacionet/Procesi	Mesatar	<ol style="list-style-type: none"> Hartimi i një PSV-je për përgatitjen e Termave të Referencës për prokurimet publike. Informimi i punonjësve të bashkisë për përmbajtjen e PSV-së. 	<p>Sektori Juridik, i Prokurimeve Publike dhe Arkivit në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore</p> <p>Gjashtëmujori i dytë i vitit 2022</p>
5	Kuadër i brendshëm rregullator jo i plotë në lidhje me rekrutimet në bashki.	Operacionet/Ligjor dhe kontraktual	Mesatar	<ol style="list-style-type: none"> Hartimi dhe Miratimi i PSV-së për rekrutimin dhe promovimin e burimeve njerëzore. Publikimi i këtyre procedurave në faqen zyrtare të Bashkisë për njohje dhe transparencë me publikun. Koordinimi me DAP-in për shpalljen e 	<p>Sektori i Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të Prokurimeve Publike dhe Arkivit</p> <p>Koordinatori për të</p>

				kërkesave për rekrutim.	Drejten e Informimit Gjashtëmujori i dytë i vitit 2022
6	Mungesa e dokumentit të politikës së privatësisë (për mbrojtjen e të dhënave personale).	Burimet Njerëzore/ Ligjor dhe kontraktual	Mesatar	1. Hartimi i një dokumenti të brendshëm politikash për mbrojtjen e të dhënave personale. 2. Informimi i personelit të të gjithë drejtorive mbi këtë dokument të miratuar. 3. Publikimi i këtij dokumenti në faqen zyrtare të Bashkisë për njohje dhe transparencë me publikun.	Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori Juridik, i Prokurimeve Publike dhe Arkivit Koordinatori për të Drejtën e Informimit Gjashtëmujori i dytë i vitit 2023
7	Mungesa e një plani vjetor për trajnimet e brendshme.	Operacional	Mesatar	1.Hartimi dhe miratimi i një Plani Vjetor për Trajnimet e Brendshme, bazuar në nevojat e punonjësve. 2. Informimi i stafit të bashkisë mbi këtë plan.	Grup pune i drejtuar nga Sektori i Burimeve Njerëzore me pjesëmarrjen e drejtuesve të të gjitha drejtorive funksionale të Bashkisë. Gjashtëmujori i dytë i vitit 2022
8	Kodi i Etikës për Audituesin e Brendshëm nuk është miratuar.	Operacionet/Strategjik	I lartë	1.Hartimi dhe miratimi i Kodit të Etikës për Audituesin e Brendshëm.	Sektori i Auditit dhe Sektori Juridik, i Prokurimeve Publike dhe Arkivit, nën kujdesin e Kryetarit të Bashkisë. Gjashtëmujori i parë i vitit 2023

9	Mungesë e Deklaratës së Auditit të Brendshëm	Operacionet/Indicie Korrupsioni	I lartë	Hartimi dhe miratimi i Deklaratës së Auditit të Brendshëm.	Sektori i Auditit dhe Sektori Juridik, i Prokurimeve Publike dhe Arkivit, nën kujdesin e Kryetarit të Bashkisë. Gjashtëmujori i parë i vitit 2023
10	Detyrimi i ndarjes së Raportit të Auditimit të Brendshëm me strukturat e Bashkisë nuk është formalizuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë.	Operacionet/Reputacional dhe Imazhi	Mesatar	1. Parashikimi në Rregulloren e Brendshme e detyrimit të bashkisë për ndarjen e raportit të Auditimit të brendshëm me strukturat e bashkisë. 2. Informimi i stafit të bashkisë për këtë detyrim.	Sektori i Auditit, Sektori Juridik, i Prokurimeve Publike dhe Arkivit dhe Koordinatorin për të Drejtën e Informimit Gjashtëmujori i parë i vitit 2023
11	Mungesa e e instrumentit për administrimin e shërbimit publik.	Operacionet/Reputacionale dhe Imazhi	Mesatar	1. Vendosija e kriterëve të paracaktuara dhe të matshme lidhur me performancën e instrumentit të zgjedhur të shërbimit publik.	Sektori i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave Civile në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të Prokurimeve Publike dhe Arkivit Gjashtëmujori i parë i vitit 2023
12	Mungon PSV-ja për hartimin dhe menaxhimin e kontratave publike.	Operacionet	Mesatar	1. Hartimi i PSV-së për hartimin dhe menaxhimin e kontratave publike. 2. Informimi i stafit të bashkisë për përmbajtjen e PSV-së.	Sektori Juridik i Prokurimeve Publike dhe Arkivit, Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Ndhmës Ekonomike dhe Sektori i Shërbimeve Publike dhe

					Emergjencave Civile Gjashtëmujori i dytë i vitit 2022
13	Mungesë e Strategjisë së Administrimit të Pronave Bashkiake.	Operacionet/Strategjik	I lartë	1.Hartimi dhe miratimi i Strategjisë së Administrimit të Pronave Bashkiake. 2. Publikimi i strategjisë në Programin e Transparencës.	Grup pune me përfaqësues nga të gjithë sektorët e Bashkisë i drejtuar nga Kryetari i Bashkisë. Koordinatori për të Drejtën e Informimit Gjashtëmujori i parë i vitit 2024
14	Mungesë e planit për përdorimin e pronave të bashkisë në bazë të marrëdhënieve kontraktuale.	Operacionet/Informacioni	Mesatar	1. Hartimi i planit të përdorimit të pronave në bazë të marrëdhënieve kontaktuale dhe të përfshihet si kapitull i veçantë në Strategjinë e Administrimit të Pronave Bashkiake.	Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Ndhmës Ekonomike Sektori i Zhvillimit Rural dhe Bujqësisë Gjashtëmujori i parë i vitit 2024
15	Mungesë e rregullave të brendshme për trajtimin e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve për administrimin e pronave bashkiake.	Operacionet/Reputacional dhe Imazhi	Mesatar	1. Hartimi dhe miratimi i rregullave të brendshme mbi mënyrat e trajtimit të ankesave dhe kërkesave të qytetarëve në lidhje me pronat bashkiake. 2. Informimi i personelit të bashkisë mbi këto rregulla. 3. Publikimi i rregullave në Programin e Transparencës.	Sektori Juridik i Prokurimeve Publike dhe Arkivit, Sektori i Zhvillimit Rural dhe Bujqësisë Koordinatori për të Drejtën e Informimit

					Zyra e Shërbimit me një Ndalesë e Bashkisë. Gjashtëmujori i dytë i vitit 2023
16	Mungesë e PSV-së për Drejtorinë e Urbanistikës dhe Planifikimit Vendor të Bashkisë, për proceset e punës që kryen kjo drejtori.	Operacionet/Ligjor dhe Kontraktual	Mesatar	<ol style="list-style-type: none"> Hartimi i një PSV-je për proceset e punës që administron Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit Vendor në Bashki. Informimi i punonjësve në lidhje me këtë PSV. Publikimi i PSV-së në Programin e Transparencës. 	<p>Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit Vendor të Bashkisë</p> <p>Spektori i Burimeve Njerëzore</p> <p>Spektori Juridik i Prokurimeve Publike dhe Arkivit</p> <p>Koordinatori për të Drejtën e Informimit</p> <p>Gjashtëmujori i parë i vitit 2023</p>
17	Mungesa e Raportit Vjetor të Transparencës.	Operacional	Mesatar	<ol style="list-style-type: none"> Hartimi, miratimi dhe publikimi i Raportit Vjetor të Transparencës. 	<p>Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik/ Koordinatori për të Drejtën e Informimit, Sekretari i Këshillit Bashkiak</p> <p>Gjashtëmujori i dytë i 2022-it e në vazhdim.</p>

